VENDIM
Nr.217, datë 24.5.1997

PËR DHËNIEN ME QIRA TË DEPOVE TË KARBURANTEVE TË USHTRISË

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënia me qira për të tretët deri në një vit të depove të karburantit të ushtrisë, të mbetura përkohësisht të lira, bëhet nga Ministria e Mbrojtjes me miratim të Ministrisë së Privatizimeve.

2. Përcaktimi i qiramarrësit do të realizohet nëpërmjet ankandeve të hapura, të organizuara nga repartet ushtarake që i kanë në administrim depot e karburantit, të miratuara nga Ministria e Mbrojtjes për t'u dhënë me qira.

3. Tarifat minimale mujore për efekt ankandi për çdo m^3 kapacitet bartës rezervuari që jepet me qira, të jenë:

a) Në qytetet Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Fushë-Krujë e Laç 3 dollarë USA.

b) Në rrethin Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier e Kurbin 2.5 dollarë USA.

c) Në qytetet që nuk përfshihen në pikën 3-a, 2.5 dollarë USA.

ç) Në rrethet që nuk përfshihen në pikën 3-b, 2 dollarë USA.

4. Të ardhurat nga qiradhënia e depove të karburantit të konsiderohen si të ardhura dytësore për Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino